

NGA STRATEGJIA PËR ZGJERIM DHE SFIDAT KRYESORE 2014-2015:

Komisioni Evropian (KE) sjell një qasje të re me qëllim të përmirësimit të menaxhimit ekonomik dhe konkurrencës në vendet që janë në procesin e zgjerimit të BE-së. Qasja e re parashikon që deri më 31 janar të vitit 2015, Maqedonia duhet të parashtrijë Program Kombëtar për Reformë Ekonomike në të cilin duhet të hartohet kornizë afatmesme makro-ekonomike dhe fiskale me theks të veçantë në procesin e qëndrueshmërisë së jashtme të vendit dhe pengesat strukturore për zhvillim, si dhe reforma konkrete për mbështetje të politikave relevante.

NGA RAPORTI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR VITIN 2014 PËR PLOTËSIMIN E KRITEREVE EKONOMIKE:

POLITIKA EKONOMIKE

1. Disiplina fiskale dhe transparenca janë përkeqësuar edhe më shumë, duke ndikuar në rritjen e shpenzimeve kapitale.
2. Politika ekonomike dhe menaxhimi me shpenzimet publike mbeten të udhëhiqen nga ad-hoc probleme për dallim nga nevojat afatgjate të ekonomisë.
3. Gjendja me transportin dhe infrastrukturën energjetike e ndalon zhvillimin ekonomik në shumë sektorë.
4. Pjesa e investimeve direkte të huaja në PBV mbetet relativisht e ulët dhe vetëm 40% prej tyre kanë formë të *greenfield*-investimeve në vitin 2013.



3. Synimi i deficitit të buxhetit shtetëror në vitin 2013 është rritur nga 3.6% në 3.9% të PBV për shkak të rritjes së madhe të pagesave në bazë të pensioneve dhe obligimeve të arritura ndaj firmave, ndërsa deficitit real e ka arritur nivelin e 4.1% dhe me atë është tejkaluar edhe niveli i reviduar. Shpenzimet publike ishin koncentruar kryesisht në periudhën parazgjedhore dhe deri në fund të korrikut 85% i deficitit të parashikuar të buxhetit ishte realizuar. Ligji për Disiplinë Financiare përmban fyerje të mëdha dhe zbatim të vonuar për subjektet qeveritare, me çfarë edhe bllokohet efektiviteti i tij.
4. Borxhi i qeverisë qendrore ishte 40,8% e PBV në fund të korrikut 2014, para lëshimit të euro-obligacionit, në krahasim me nivelin e 34,1% në fund të vitit 2012 dhe 20,6% në fund të 2008. Borxhi i akumuluar nga ndërmarrjet publike dhe pjesa e obligimeve qeveritare për shkak të garancive për borxhet e ndërmarrjeve publike, që është vlerësuar në 8% të PBV, është një brengë serioze sepse qeveria ka transferuar një pjesë të madhe të shpenzimeve të mëdha në ndërmarrjen e re për ndërtimin e rrugëve, që është jashtë buxhetit shtetëror. Gjithashtu, borxhi i plotë publik është rreth 50% të PBV dhe me siguri do të rritet edhe më tutje në afat të shkurtër dhe mesëm duke marrë parasysh nevojat serioze financiare që janë të lidhura me projektet e planifikuara për investim.
5. Rritja e vazhdueshme në të gjitha nivelet e borxhit qeveritar dhe publik e rrit brengosjen për qëndrueshmërinë afatgjate. Qeveria duhet të ndërmarrë hapa për të stabilizuar nivelet e borxhit.
6. Shpenzimet kapitale janë relativisht një pjesë e vogël e shpenzimeve të përgjithshme dhe janë rreth 12% të shpenzimeve të përgjithshme në vitin 2013 dhe i nënshkrohen realizimit të pakompletuar.

HYRJE DHE DALJE NË TREG

1. Kompanitë ende përballohen me vështirësi gjatë sigurimit të licencave dhe lejeve, sepse sistemi i një-sportelit zhvillohet shumë ngadalë dhe duhet të zgjerohet edhe në aktivitetet afariste të cilat nuk përbëhen vetëm nga dhënia e licencave për ndërtim.
2. Në lidhje me zonat e lira ekonomike, kompanitë vendore nuk i gëzojnë kushtet e njëjta sikur kompanitë e huaja, veçanërisht në aspekt të privilegjeve.

3. Obligimet e arritura të Qeverisë ndaj kompanive paraqesin kërcënim për likuiditetin e bizneseve.

SISTEMI JURIDIK

1. Zbatimi i marrëveshjeve për punë të kompanive private është vështirësuar dhe karakterizohet me procedura të shtrenjta dhe të gjata, procedura joefikase për licencim dhe shpesh bëhet zbatim i jo-barabartë i të drejtës.
2. Përhapja e ekonomisë së zezë vazhdon të kërcënojë konkurrencën dhe zhvillimin e sektorit privat.



KAPITALI FIZIK DHE NJERËZOR

1. Niveli i arsimit dhe trajnimit të fuqisë së papunësuar nuk përputhet me nevojat e ekonomisë. Një e katërta e punëtorëve me arsim sipëror janë të papunësuar, sepse pjesa më e madhe e ofertës së vendeve të punës gjatë viteve të fundit ishte në sektorët e produktivitetit të ulët. Masat e Qeverisë me të cilat adresohen sfidat e tregut të punës (subvencione për punësim dhe grante për fillim të bizneseve) nuk i trajtojnë shkaqet strukturore të papunësisë.

NDIKIMI SHTETËROR MBI KONKURENCËN

1. Njoftimi për ndihmë shtetërore është i kufizuar.
2. Ekziston një spektër i gjerë i instrumenteve me të cilat Qeveria ka ndikim të zmadhuar mbi konkurrencën e ekonomisë dhe sektorët e ndryshëm dhe kompanitë, siç janë: subvencione direkte dhe lehtësime tatimore, veçanërisht për investitorët e huaj; inspektime direkte në firmat dhe gjoba; ri-programim i dhunshëm i marrëveshjeve për pagesë; garanci publike për huat e ndërmarrjeve që janë në pronësi të shtetit; projekte publike të infrastrukturës dhe programe aktive për tregun e punës.

STABILITETI MAKRO-EKONOMIK

1. Papunësia e të rinjve është mbi 50% dhe katër nga pesë të regjistruar si të papunësuar janë pa punë më tepër se një vit. Ndonëse informtë e plotë për punësimet në sektorin publik nuk ishte dhënë madje as publikuar, vlerësohet që pjesa e tyre në punësimin e përgjithshëm paraqet 20%. Disiplina fiskale dhe cilësia e shpenzimeve publike janë përkeqësuar edhe më shumë në vitin 2013 dhe 2014. Qeveria ishte e detyruar të bëjë rebalanc të buxhetit për shkak të presionit që vinte nga të ardhurat e zvogëluara dhe pagesën e obligimeve të arritura ndaj firmave private në pjesën e parë të vitit.
2. Huamarrja e rritur e qeverisë jashtë vendit dhe kërkimi për kredi të huaja për ndërmarrjet publike ishin arsye kryesore për rritjen graduale të bruto borxhit të jashtëm. Në fund të katërmujorshit të parë të vitit 2014, ai ishte 66% të PBV dhe prej atëherë vazhdimisht po rritet, kryesisht si rezultat i dhënies së euro-obligimeve qeveritare në shumë prej 500 milion eurosh në qershor. Investimet e huaja dhe huamarrja qeveritare jashtë vendit do të duhet të bartin peshën dhe të jenë burime kryesore për financim të deficitit të llogarisë aktuale, që me siguri për një afat të shkurtër do të rritet edhe më shumë, nëse merret parasysh nevoja e rëndësishme për eksport që del nga projektet për infrastrukturë publike dhe themelimit të entiteteve të reja të huaja.

